URDHËR
Nr. 337, datë 16.9.2019

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 34, DATË 26.1.2000, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PLANIT TË EMERGJENCAVE NË MINIERA"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe vendimin nr. 341, datë 22.5.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e emergjencave dhe shpëtimin, si dhe procedurave të hartimit, përmbajtjes e miratimit të planit të emergjencës, të detyrueshme për subjektet që kryejnë punime nëntokësore dhe subjektet e tjera që kryejnë punime në nëntokë, në miniera apo në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike",

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 34, datë 26.1.2000, "Për miratimin e rregullores së planit të emergjencave në miniera".
2. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera të ndjekë procedurat për njoftimin e subjekteve që kryejnë veprimtari minerare nëntokësore në miniera.
3. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku